

Fjalat e Paqes



*E kur të vijë ai -
Shpirti i së Vërtetës-
Ai do t'ju udhëzojë ta
njihni tërë të Vërtetën.
(Gjn 16,13)*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 3 (122) Viti XVII Prill - Maj 2015**

PAPA FRANÇESKU KOMITETIT TË BASHKUAR KEK-KKIE FLISNI ME NJË ZË TË VETËM

Anëtarët e Komitetit të Bashkuar të Konferencës së Kishave Europiane (KEK) dhe të Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Europës (KKIE) janë takuar në Romë, me dt. 6-8 maj 2015. Me 7 maj patën Audiencën me Papën.

Në orën 10.00 Ati i Shenjtë Françesku pranoi në Audiencë Anëtarët e Komitetit të Bashkuar dhe pas përshëndetjes së Presidentëve u drejtoi të pranishëmve fjalimin, që vijon:

Të dashur vëllezër e motra,

ju jap mirëseardhjen time të përzemërt dhe ju falënderoj për vizitën tuaj. Falënderoj në veçanti Kardinalin Péter Erdő dhe të Nderuarit Christopher Hill për fjalët e tyre të përzemërta.

Komiteti që ju tani përbëni ka qëllimin të shoqërojë ecjen ekumenike në Europë, ku kanë filluar shumë prej ndarjeve që ende ekzistojnë mes të krishterëve. Për një kohë të gjatë të krishterët e këtij kontinenti kanë luftuar kundër njëri-tjetrit. Sot, faleminderit Hyjit, situata është shumë e ndryshme. Lëvizja ekumenike u ka lejuar Kishave dhe Bashkësive kishtare në Europë që të bëjnë hapa të mëdhenj në rrugën e pajtimit dhe të paqes. Asamblatë Ekumenike Europiane të kohëve të fundit dhe Charta Oecumenica, e redaktuar në Strasburg në vitin 2001, janë faktorë

të bashkëpunimit të frytshëm mes Konferencës së Kishave Europiane dhe Këshillit të Konferencave Ipeshkvore Europiane. Këto nisma janë arsye shprese të madhe për kapërcimin e ndarjeve, megjithëse me vetëdijen se sa e gjatë është rruga drejt bashkimit të plotë dhe të dukshëm mes të gjithë besimtarëve në Krishtin. Por, në të vërtetë, ecja, me të gjitha mundimet e veta, tashmë është pjesë përbërëse e procesit të pajtimit dhe të bashkimit që Zoti na kërkon dhe na bën të kryejmë, mjafton që të jetojmë në dashuri dhe në të vërtetë.

Dekreti konciliar mbi ekumenizmin “Unitatis redintegratio” pohon se ndarja mes të krishterëve “dëmton çështjen shumë të shenjtë të predikimit të ungjillit çdo krijese” (nr. 1). Kjo duket qartë, për shembull, kur Kishat dhe Bashkësitë kishtare në Europë paraqesin vizione të ndryshme mbi çështje të rëndësishme antropologjike apo etike. Prandaj uroj që të mos mungojnë dhe të jenë të frytshme rastet e reflektimit të përbashkët, në dritën e Shkrimit të Shenjtë dhe të traditës së bashkëndarë. Duke shikuar së bashku drejt Zotit Jezu Krisht, që “duke zbuluar misterin e Atit dhe të dashurisë së tij ia zbulon plotësisht njeriun njeriut dhe ia bën atij të njohur thirrjen e tij tejet të lartë” (Konc. II Ekum. i Vat., Kusht. barit. Gaudium et spes, 22), mund të gjejmë përgjigje të

Vijon në fq. 2



**SFIDAT E BARITORES
SË FAMILJES
NË BUKURESHT**

Faqe 3-4

**RELIKET E
SHËN GJON BOSKOS
NË SHKODËR**

Faqe 5

**TOKA NXJERR NË DRITË
RELIKE TË ÇMUESHME**

Faqe 12

PAPA FRANÇESKU KOMITETIT TË BASHKUAR KEK-KKIE “FLISNI ME NJË ZË TË VETËM”

Vijim i fq. 1

përbashkëta ndaj pyetjeve që shoqëria bashkëkohore na shtron ne të krishterëve. Sa më afër Krishtit të jemi, aq më shumë do të jemi të bashkuar mes nesh.

Sot Kishave dhe Bashkësive kishtarë në Europë u duhet të përballojnë sfida të reja dhe vendimtare, të cilave mund t'u japin përgjigje efikase vetëm duke folur me një zë të vetëm. Mendoj, për shembull, për sfidën e paraqitur prej legjislacionesh që, në emër të një parimi tolerance të keqinterpretuar, arrijnë t'i pengojnë shtetasit t'i shprehin lirisht dhe t'i praktikojnë në mënyrë paqësore e të ligjshme bindjet e tyre fetare. Gjithashtu, përballë qëndrimit me të cilin Europa duket se përballon migrimin dramatik dhe shpesh tragjik të mijëra personave që ikin nga luftërat, përndjekjet dhe mjerimi, Kishat dhe Bashkësitë kishtarë në Europë kanë detyrën të bashkëpunojnë për të nxitur solidaritetin dhe mirëpritjen. Të krishterët e Europës janë të thirrur të ndërmjetësojnë me lutje dhe të veprojnë aktivisht për të sjellë dialoge paqe në konfliktet në akt.

Duke përtërirë mirënjohjen time për shërbimin tuaj kishtar, thërras mbi të bekimin e vazhdueshëm të Zotit. Ju lutem, mos harroni të luteni për mua”.

TEMA I TAKIMIT

“Për një Europë të Lirisë” Liria dhe liritë:
një propozim i krishterë

Takimi i përvitshëm i Komitetit të bashkuar KEK-KKIE këtë vit u zhvillua në Romë nga 6 deri më 8 maj me ftesën e Kardinalit Angelo Bagnasco, President i Konferencës ipeshkvore Italiane dhe Zëvendës President i KKIE.

Pjesëmarrësit u mblodhën për të diskutuar mbi temën: Liria dhe liritë: një propozim i krishterë. U bënë reflektime nga perspektiva katolike, protestante dhe ortodokse.

Një pikë kulmore e takimeve qe audienca me Papa Françeskun, të enjten më 7 maj. Ati i Shenjtë theksoi nevojën për kishat në Europë që të gjejnë “përgjigje të përbashkëta për problemet që shoqëria

bashkëkohore na shtron ne të krishterëve”.

Pjesëmarrësit takuan edhe ambasadorin britanik pranë Selisë së Shenjtë, Sir Nigel Baker, që theksoi se si shtetet dhe kishat bashkëndajnë një interes të përbashkët për të ruajtur vlerat e krishtera për të mirën dhe nxitjen e demokracisë e të paqes në Europë.

Kardinali Kurt Koch, President i Koncilit Papnor për bashkimin e të

krishterëve,
përsëriti
pjesëmarrësit të
premtën në mëngjes.

Takimi i Romës u karakterizua nga momente lutjeje sipas traditave të ndryshme të emërtimeve të krishtera të pranishme në takim.

M e s a z h i përfundimtar

Pjesëmarrësit e përfunduan takimin e tyre duke zgjedhur mesazhin që vijon mbi temën e takimit, me dt. 6-8 maj 2015:

“Për një Europë të lirisë”

M e s a z h i i
Komitetit të Bashkuar

të Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Europës (KKIE) dhe të Konferencës së Kishave Europiane (KEK).

Ne europianët, gëzojmë një liri të pafundme në jetën tonë të përditshme. Kemi një borxh ndaj brezëve që na kanë paraprirë dhe që kanë luftuar për të ndërtuar një rend shoqëror në të cilin e mira e përbashkët dhe liria e personave të mund të bashkëjetojnë në harmoni.

Në këtë 70-vjetor të fundit të Luftës II Botërore, na kujtohet lufta e madhe, dhe nganjëherë e dhunshme, kundër ideologjive bartëse të vdekjes. Kjo luftë për lirinë i ka dhënë fillesë Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe të Lirive Themelore, që thekson faktin se liria është gjithmonë e bashkuar me detyra dhe përgjegjësi.

Në hijen e këtij momenti të errët të historisë, përtërijmë angazhimin tonë për një vizion të lirisë që të jetë efikas për të gjithë.

Në një Europë pluraliste jemi të bindur se ka nevojë për një vizion të

krishterë të lirisë
njerëzore. Mendojmë
se kjo liri është pjesë e
jona sepse Hyji na ka
krijuar të lirë. Liria jonë
e krishterë është një
dhuratë e Hyjit e
rrënjësuar në Krishtin
dhe na thërret në një
jetë shërbimi të
ndërsjellë. Krishti na
sfidon ta përdorim
lirinë tonë për ta
realizuar mbretërinë e
Hyjit këtu dhe tani.
Nuk ka liri jashtë një
lirie me dhe për të
tjerët.

Vijon në fq. 4



*) **Konferenca e Kishave Europiane (KEK)** është një bashkim i 114 Kishave ortodokse, protestante, anglikane e katolike të vjetra të të gjitha vendeve europiane, dhe e 40 këshillave kombëtare të kishave e organizatave të asociuara. E themeluar në vitin 1959, KEK ka zyra në Gjenevë, Bruksel dhe Strasburg.

) **Këshilli i Konferencave Ipeshkvore të Europës (KKIE) përfshin 33 Konferencat Ipeshkvore Europiane aktuale, të përfaqësuara prej Presidentëve të tyre, prej Arqipeshkvinjve të Luksemburgut dhe të Principatës së Monakos, prej Arqipeshkvit të Qipros së Maronitëve, prej Ipeshkvit të Chişinău (Rep. Moldove), prej Ipeshkvit eparkial të Mukachevo-s dhe prej administratorit apostolik të Estonisë. Presidenti aktual është Kardinali Péter Erdő, Arqipeshkëvi i Esztergom-Budapest, Primat i Hungarisë, Zëvendëspresidentët janë Kardinali Angelo Bagnasco, Arqipeshkëvi i Gjenovës, dhe Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëvi i Shkodër-Pultit, Shqipëri. Sekretari i Përgjithshëm i KKIE është Imzot Duarte da Cunha. Sekretariati e ka selinë në San Galo (Zvicër). www.ccee.eu

PRESIDENTËT E KONFERENCAVE IPESHKVORE TË JUG-LINDJES SË EUROPËS, NË BUKURESHT

SFIDAT E BARITORES SË FAMILJES

Rumani, 17-21 prill 2015

Duke vazhduar një traditë që ka zgjatur më se dhjetë vjet (2002-2012), presidentët e Konferencave ipeshkvore të vendeve të Jug-Lindjes së Europës janë takuar nga data 17 deri më 21 prill 2015 në Bukuresht (Rumani). Takimi, i realizuar në kuadrin e veprimtarive të Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Europës (KKIE), u zhvillua në Rumani, me ftesën e Arqipeshkvit Metropolit të Bukureshtit dhe Presidentit të Konferencës Ipeshkvore Rumune, Imzot Ioan Robu.

Ngjashmëria e sfidave baritore dhe e situatës së kishës katolike në këto vende është arsyeja e këtyre takimeve. Dy ishin qëllimet: të

f o r c o h e n marrëdhëniet e bashkimit kishtar duke bashkëndar sfidat baritore të përbashkëta si dhe të shqyrtohen disa çështje në lidhje me temën e familjes në përgatitje për Sinodin e ardhshëm të Zakonshëm të Ipeshkvinjve (tetor 2015) si dhe në dritën e Sinodit të Jashtëzakonshëm të vitit 2014.

Në dialogun ballafaqimin mbi temën e familjes, Ipeshkvinjtë u ndalën në sfidat baritore që vijnë:

1. Në martesat e përziera mes katolikëve dhe ortodoksëve. Ekzistojnë sfida dhe probleme për shkak të ndryshimit në mënyrën e konceptimit të martesës dhe sakramentalitetit të saj; por duhet që çiftet të shoqërohen në një ecje feje, në mënyrë që ndryshimet të mos çojnë në një relativizëm dhe në një indiferencë fetare. Nëse jetojnë mirë, martesat e përziera janë përjetim i një dialogu të njëlloshëm ekumenik. Kjo temë ka qenë edhe më parë objekt i një reflektimi të thellë në një takim të tyre në Sofje (Bullgari) në vitin 2008.

2. Në ekonominë e globalizuar që nuk ka kujdes as vëmendje për të varfrit dhe as për të rinjtë dhe që shpesh i detyron njerëzit e kësaj zone të Europës që të kërkojnë punë në zona të tjera të botës. E migrimet janë një sfidë e madhe për familjen e cila ka nevojë për një vëmendje të veçantë nga ana e Kishës. Shumë familje janë të ndara për arsye të emigrimit. Shpresohet një bashkëpunim më i ngushtë baritor mes vendeve të prejardhjes dhe atyre të mbërritjes, si për shembull, për sa i përket përgatitjes për martesë: bashkësitë katolike të vendeve që mirëpresin emigrantët do të duhej të garantonin një përgatitje dhe pastaj një shoqërim të çifteve të reja që vijnë për t'u martuar në vendet e tyre të prejardhjes.

3. Në faktin se përgatitja për martesë duhet të jetë në çdo rast shumë serioze dhe e zhvilluar në një logjikë baritore mirëpritjeje, që çdokush të ndihet i pranuar dhe i gatshëm për një ecje përgatitjeje që është edhe një kohë e takimit me Jezusin dhe me fenë. Duhet të mos harrojmë sfidat e paraqitura nga një kulturë digjitale që, duke lejuar hyrjen në një informacion të gjerë, jo gjithmonë është e integruar në një personalitet të pjekur të aftë për të marrë vendime përfundimtare dhe për të marrë përsipër përgjegjësinë e një familjeje.

4. Në baritoren e familjes, që nuk mund të jetë një baritore mase por një baritore afërsie dhe kontaktesh personale. Në vendet e Jug-Lindjes Europiane, ndjenja e familjes është shumë e gjallë. Familja çmohet dhe

dëshirohet prej të rinjve. Për këtë baritore janë të rëndësishëm qoftë meshtarët, qoftë edhe çiftet e të martuarve që kanë një rol të rëndësishëm në shoqërimin në momenteve të lumtura dhe në provat.

5. Në grupet e familjeve. Pjesëmarrësit vunë në dukje me kënaqësi dhe si arsye shprese praninë e grupeve të familjeve dhe të atyre lëvizjeve që kanë një karizëm të veçantë të kushtuar familjes dhe që përbëjnë një burim themelor për baritoren e familjes.

6. Së fundi, pjesëmarrësit deshën të kujtonin se familja e krishterë bazohet, rritet dhe zhvillohet me “Eukaristinë e së dielës, kur me të gjithë Kishën, familja ulet në sofrën e Zotit. Ajo na dhurohet të gjithëve ne, shtegtarë në histori drejt caktimit të takimit të fundit kur «Krishti do të jetë gjithçka në të gjithë» (Kol 3,11)” (Papa Françesku, Mesazhi i Asamblesë III të Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Sinodit të Ipeshkvinjve).

Në fund pjesëmarrësit, të impresionuar prej ndërtimit të rrezikshëm dhe të paligjshëm të një pallati pranë Katedrales së Shën Jozefit, të deklaruar Monument historik me interes kombëtar dhe ndërkombëtar në vitin 1955, firmosën një deklaratë, duke dëshmuar solidaritetin e tyre me

përpjekjet e Kishës Katolike të Bukureshtit për ta zgjidhur çështjen. Urojnë që Autoritetet Publike të respektojnë vendimet e pakthyeshme të Gjykatës së Apelit të Ploiestit dhe të Gjykatës së Lartë për ta ndërtuar përsëri lulishten që ekzistonte më parë.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Bukuresht, Deti Mesdhe ka jetuar edhe një tragjedi tjetër, duke përpirë jetën e më shumë se 700 vetave, në kërkim të një jete më dinjitoze dhe që janë shfrytëzuar nga njerëz të paskrupujt.

Vijon në fq. 4



PAPA FRANÇESKU KOMITETIT TË BASHKUAR KEK-KKIE “*FLISNI ME NJË ZË TË VETËM*”

Vijim i fq. 2

Liria, që bazohet në të vërtetën, gjendet jo rrallë në konflikt me ata që kaq shpesh takohen gjetiu në shoqëritë tona. Tepër shpesh ndeshemi me interpretime të lirisë të kuptuar si kënaqësi individualiste dhe konsum pa domethënie. Në takimin tonë të Romës kemi diskutuar disa aspekte të lirisë të orientuara nga përgjegjësia ndaj Hyjit dhe ndaj të afërmit:

Kërkojmë një liri që padit shtypjen dhe dhunën kundër grave të kryer në emër të çfarëdo besimi.

Kërkojmë një liri që i shpëton migrantët në Mesdhe, që vepron për t'u dhënë fund shkaqeve të migrimit të dëshpëruar dhe u lejon të gjithëve të jetojnë në paqe në vendet e tyre të prejardhjes.

Kërkojmë një liri që shpreh fjalë solidariteti kundër paragjykimeve në lidhje me romët.

Kërkojmë një liri që angazhohet për t'i dhënë fund skllavërisë dhe trafikut të qenieve njerëzore të kohëve moderne në të gjithë botën në përputhje me kërkesën e udhëheqësve fetarë të 2 dhjetorit të kaluar mbi shfuqizimin e skllavërisë.

Kërkojmë një liri që e përkufizon Krijimin si dhuratë e shenjtë, veçanërisht tani që bashkësitë rregulltare duan ta bashkëndajnë reflektimin e tyre mbi çështjet mjedisore dhe përpiqen të shoqërojnë bisedimet e Parisit (COP21) mbi ndryshimin klimatik në dhjetor.

Kërkojmë një liri që zgjedh shpresën në vend të dëshpërimit, dhe jeton në solidaritet me të rinjtë në përpjekjen e tyre për të filluar jetën e punës dhe për të formuar një familje.

Të na lejohet t'i përdorim zemrat tona të lira dhe mendjet tona të lira për t'i shëruar plagët dhe për të nxitur shpresën e botës sonë të munduar e megjithatë të bekuar.

Shtatëdhjetë vjet pas fundit të Luftës II Botërore, lutemi për paqen në Europë dhe në botë që duhet të jetë gjithmonë fryt i drejtësisë.

Në gjithçka që bëjmë, të mund të dëgjohet jehona e britmës së shkrimeve “Vërtet, vëllezër, ju jeni të grishur në liri! Por, kini kujdes që kjo liri të mos bëhet shkak të jetoni si do trupi, por - me dashuri shërbejini njëri-tjetrit!” (Galati 5, 13)

KEK

I nderuari Christopher Hill, Ipeshkëv i Guildford dhe President Shumë e nderuara Karin Burstrand, Kisha e Suedisë, Zëvendës-Presidente

Metropoliti Emmanuel di France, Metropolia Greko-Ortodokse e Francës (Ezarkati i Patriarkatit Ekumenik), Zëvendës-President

E nderuara Adriana Florea, Kisha Ungjillore A.B. në Rumani

E nderuara Silke Tosch, Bashkimi i Kishave Ungjillore të Lira në Gjermani

Metropoliti Joseph, Metropolia Ortodokse Rumune e Europës Perëndimore dhe Jugore

I nderuari Archimandrita Ignatios Sotiriadis, Kisha e Greqisë

I nderuari Guy Liagre, Sekretar i përgjithshëm.

Erin Green, *Koordinatorë e Komunikimit*

Tel: +32 2 234 68 42; e-mail: eeg@cec-kek.be

KKIE

Kardinali Péter Erdő, Arqipeshkëv i Esztergom-Budapest, President

Kardinali Angelo Bagnasco, Arqipeshkëv i Gjenovës, Zëvendës-President

Shkëlq. e Tij Imzot. Angelo Massafra (OFM), Arqipeshkëv i Shkodër-Pultit, Zëvendës-President

Shkëlq. e Tij Imzot. Ján Babjak (S.J.) Arqipeshkëv i Prešov

Shkëlq. e Tij Imzot. Roland Minnerath, Arqipeshkëv i Dijon

Shkëlq. e Tij Imzot Kevin McDonald, Arqipeshkëv nderi i Southëark Atë Patrick Daly, Sekretar i përgjithshëm i COMECE

Imzot Duarte da Cunha, Sekretar i përgjithshëm

Thierry Bonaventura, *Përgjegjës i Shtypit*

Tel. +41 71 227 6044, cell. +41 79 12 80 189

e-mail bonaventura@ccee.eu

PRESIDENTËT E KONFERENCAVE IPESHKVORE TË JUG-LINDJES SË EUROPËS, NË BUKURESHT

Vijim i fq. 3

Pjesëmarrësit në takim u lutën për ta dhe për të gjithë ata që kanë humbur jetën në mënyrë të ngjashme si dhe për familjarët e tyre, duke e bashkuar zërin e tyre me të gjithë ata që nuk pranojnë të dorëzohen para dhunës e shfrytëzimit dhe përsërisin me forcë se çdo njeri duhet të respektohet në dinjitetin e vet si bir i Hyjit.

Në takim morën pjesë Em. Tij. Kardinali Vinko Puljić, Arqipeshkëv i Sarajevës dhe President i Konferencës ipeshkvore të Bosnje-Hercegovinës, Imzot Angelo Massafra OFM, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit, President i Konferencës ipeshkvore të Shqipërisë dhe Zëvendës-president i KKIE, Imzot Fragkiskos Papamanólis (OFM. Kap), ipeshkëv emerito i Syros-Kretë-Santorinit dhe President i Konferencës Ipeshkvore të Greqisë; dhe Imzot Christo Proykov, Ezark Apostolik i Sofjes dhe President i Konferencës Ipeshkvore të Bullgarisë.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit vizituan në qytetin e Bukureshtit Katedralen e Shën Jozefit të katolikëve të rritit latin, ku kremtuan meshën

të shtunën më 18 dhe të dielën më 19 në një kishë të mbushur përplot me njerëz; Katedralen greko-katolike të Bukureshtit ku takuan Imzot Mihai Fratila, Ipeshkëv i Eparkisë së Shën Bazilit të Madh - Bukuresht; Kishën e Shenjtes Mari të Hireve, kisha e parë katolike e Bukureshtit; motrat e Congregatio Jesu (Damat angleze), kongregatë e themeluar nga e Nderueshmja Mary Ward; varrezën katolike dhe famullinë e Shenjtes Terezë të Jezusit Fëmijë, që ka edhe dy ndërtesa të liceut katolik si dhe Manastirin e Etërve Karmelitanë të Cioflicenëve.

Në këto vende që e mundur të dëgjoheshin edhe dëshmi në lidhje me kohën e komunizmit në të cilën përndjekjet, sidomos kundër greko-katolikëve, kanë qenë shumë të ashpra.

Të dielën pasdite Ipeshkvinjtë shkuan në Konstancë, port në Detin e Zi, që është një vikariat i Arkidioqezës së Bukureshtit dhe ku qëndruan deri të hënë për të vizituar Konstancën dhe Adamklizën e për të kremtuar Meshën në Bazilikën e Shën Antonit të Padovës.

APEL PËR TË NDIHMUAR VIKTIMAT NË NEPAL

Tiranë, më 15 maj 2015

Të dashur vëllezër në episkopat,

Dje, si Presidencë, kemi shprehur mendimin tonë që, në Kishat tona, të bëjmë apel për të ndihmuar viktimat e tërmeteve në Nepal. Konkretisht kemi menduar se lëmosha që do të mblidhet në të gjitha meshat që do të kremtohen të shtunën pasdite dhe të dielën paradite dhe pasdite në të kremten e Rrëshajave të shkojë për këtë qëllim.

Prandaj ju lutem t'i njoftoni sa më shpejt famullitarët dhe rektoret e kishave në dioqezat tuaja. Ju lutem gjithashtu që pastaj lëmosha e mbledhur të më dorëzohet mua sa më shpejt dhe menjëherë do të marrim masat për të dërguar ndihmën tonë në atë vend. Ju përshëndes dhe ju falënderoj. Vëllazërisht në Krishtin,

Imzot George Frendo O.P.
Sekretari i Përgjithshëm KISH

RELIKET E SHËN GJON BOSKOS NË SHKODËR



Don Bosko është këtu. Po është e vërtetë. Ai na ka vizituar!. Të rinjtë e qytetit të Shkodrës e prisnin që prej një viti Atin e Mësuesin e tyre, e me datë 9 maj ai erdhi, u gjend mes nesh, mes të rinjve të qytetit tonë. Kjo gjë u realizua në kuadër të Dyqindvjetorit të Lindjes së Don Boskos dhe është hera e parë që ndodh kjo gjë, pra që Relikja me eshtrat e tij të lëvizte nga Torino. Don Bosko viziton botën edhe fizikisht tashmë. Shqipëria dhe Kosova kanë qene vendet e vetme në të cilat ende nuk kishte ardhur Relikja e Don Boskos. Dhe ajo që pritej nga mijëra zemra të rinjsh ndodhi.

Relikja mbërriti në Shkodër në Katedralen Sh. Shtjefni. Qe një moment që nuk i përket vetëm Familjes shpirtërore të Don Boskos, por një dhuratë për krejt qytetin tonë. Qenë fëmijët e të rinjtë protagonistë në pritjen e parë në oborrin e Katedrales, ata fëmijë që shkulin çdo ditë oborret që mbajnë emrin e këtij shenjt, grupet e katekizmit, futbollit, basketbollit, ministrantët e shumë të tjerë e krejt besimtarët me një përzemërsi dhe gëzim të tejskajshëm. Aty u këndua himni i Gjergj Fishtës, u paraqit një lexim i shkruar nga vetë Don Bosko i cili ishte shumë emocionues dhe me shumë mesazhe të vlefshme. Pastaj, përveç lutjeve personale, u lexua një lutje e përgjithësuar nga gjithë të rinjtë e Shkodrës dhe u bë procesioni për fillimin e Meshës Shenjte. Mesha u drejtua nga Imzot Zef Gashi, SDB. Mesha ishte shumë emocionuese dhe ishte ndjesi e mrekullueshme të kishe të pranishëm Sh. Gjon Boskon. Pjesëmarrja në meshë ishte e madhe dhe fytyrat e buzëqeshura të fëmijëve të vegjël shndrisnin. Dhe kjo me të drejtë, pasi përveç shpirtërisht, tashmë edhe fizikisht kishin mundësi që të takonin atë që themeloi Oratorin e tyre të dashur. Vendin në të cilin kalojnë një pasdite të shkëlqyer duke luajtur, por më vonë do të kuptojnë që është diçka më tepër se aq, është më e mrekullueshme se aq. Kjo sepse oratori funksionon sipas këshillave të Atit, Mësuesit dhe Mikut të të rinjve.

Pas përfundimit të meshës, u bë e mundur që Don Boskon ta takonin nga afër besimtarët dhe t'i paraqesnin lutjet në zemrën e tyre. Më pas, në orët e pasdites, Relikja e Don Boskos është nisur për në Shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë. Aty lutjet e besimtarëve kanë qenë të shumta dhe ka pasur dëshirë të madhe nga shumë njerëz për ta prekur dhe puthur Reliken dhe që të shmangen rrëmuajt apo problemet, është kujdesur shërbimi i pritjes, i cili është formuar nga djem dhe vajza të Oratorit Don

Bosko Shkodër dhe ka ruajtur rendin dhe ka shoqëruar në çdo vend Reliken e Don Boskos. Aty u kremtua mesha në orën 18.00, e udhëhequr nga Don Marek Gryn SDB, ku pjesëmarrja qe e madhe dhe pas përfundimit të meshës ka pasur momente takimi me Don Boskon nga besimtarët e tjerë.

Dhe pas kësaj Relikja e Don Boskos niset për në shtëpinë saleziane, në Oratorin Don Bosko Shkodër. Aty është kryer mikpritja më e përzemërt pasi aty të gjithë fëmijët e kanë pritur Mësuesin e tyre me gjithë ngrohtësinë e mundshme të zemrës që iu ka buruar nga shpirti. Thjeshtësi e autenticitet. Dy perceptime, duke parë ata fytyra të habitura e të mahnitura, duke pasur përpara, atë shenjt, emrin e të cilit e kanë në gojë përditë. Shtëpi e ëmbla shtëpi. Sapo Relikja ka zbritur nga makina ajo është pritur nga të rinjtë me duartrokitje, këngë. Tamam ashtu siç do të kishte dashur të pritej: nga të rinjtë e tij me shumë dashuri. Aty ka qëndruar gjatë gjithë natës ku është organizuar edhe një moment vigjiljeje. Janë organizuar lutje, edhe pse natën, pjesëmarrja nga njerëzit ka qenë e madhe në çdo orë. E ku kishte rëndësi ora?! Don Bosko ishte i pranishëm.

Në mëngjes të rinjtë bashkë me familjet kremtuan para Relikes Lavdet e mëngjesit. Në orën 10.00 u kremtua mesha nga Imzot Angelo Massafra, arqipeshkvi ynë, në kishën Don Bosko mes qindra të pranishmëve në kishë. Ishte dyfish më emocionues, sepse ishte në vendin e ndërtuar kushtuar vetë atij dhe funksiononte sipas mësimave të tij. Pas meshës dhe përshëndetjes së fundit nga oratorianët Relika e Don Boskos bëhet gati të nisej drejt kishës Don Bosko në Shelqet ku pritet me shumë devocion. Qëndron aty për disa orë dhe më pas në Bërdicë, famullia



saleziane. Edhe aty u kremtuan mesha dhe u prit nga qindra zemra të rinjsh dhe fëmijësh që rrihnin fort nga gëzimi i madh për të takuar Mikun, Mësuesin dhe Atin e tyre.

Pastaj Relikja kthehet në shtëpinë e motrave saleziane në Shkodër dhe aty u prit nga vajzat dhe Bijat e Marisë Ndhimtare dhe nga një grup i vogël i Oratorit. Aty ishte një moment shumë i veçantë dhe tepër i bukur lutjeje pasi ishte më familjare dhe më e afërt. Ndoshta ka qenë ambienti i vogël (kapela e motrave saleziane) ajo që e ka bërë më familjar dhe më të mrekullueshëm këtë moment, ndoshta edhe ngaqë kanë qenë momentet e fundit pranë tij (fizikisht). Ose ndoshta të dyja këto bashkë. E në mëngjesin e së hënës e kemi përcjellë Don Boskon për në Tiranë.

Të rinjtë kanë dhënë më të mirën e tyre për të pritur shenjtin e tyre. Dhe puna ka qenë e papërtuar e me shumë dashuri. Ama edhe në qoftë se ka pasur lodhje fizike, relaksi, qetësia, paqja, lumturia dhe dashuria që kanë gjetur tek Don Bosko ka qenë inspirim për to. Dhe asnjëri nuk do të hezitonte të bënte të njëjtën gjë sërish.

Ka qenë sigurisht një bekim për të gjithë ne të rinjtë, për familjet tona e krejt qytetin tonë. Don Bosko ndërmjetësoftë që t'i mbetemi besnikë mësimave të tija, e mbi të gjitha të bëjmë atë rrugë që gjatë gjithë jetës deshi t'ua mësonte të rinjve të tij: rrugën drejt Krishtit.

Leandro Kaçaj



BEKIMI I KISHËS SË FAMILJES SË SHENJTE NË BUSHAT

Që më 8 shtator 1991 vëllezërit Kontemplativë të Misionarëve të Bamirësisë janë në qytezën e Bushatit, në zonën e Shkodrës, Shqipëri. Vëllezërit e themeluan bashkësinë e tyre të vogël dhe ndërtuan kishën e Familjes së Shenjtë në Bushat, të cilën pastaj, Nunci Apostolik, Imzot Ivan Dias, e bekoi të mërkurën, më 13 janar, 1993. Mes të tjerash, Arqipeshkvi tha se kjo ishte kisha e parë e ndërtuar në Shqipëri, që me rënien e komunizmit.

Vitet kaluan. Shumë kisha më të mëdha e më të bukura u ndërtuan në arqidioqezën e Shkodrës. E para mes tyre ishte Kisha Katedrale në Shkodër, e cila u bekua dhe u shugurua nga Shën Gjon Pali II më 25 prill 1993; ai gjithashtu shuguroi katër ipeshkvij të rinj në Shqipëri, tre prej të cilëve kanë shkuar në shtëpinë e Hyjit për shpërblimin e tyre të amshuar. Edhe e Lumja Tereza e Kalkutës ishte e pranishme me këtë rast.

Me kalimin e viteve Kisha e Familjes së Shenjtë në Bushat u vjetrua. Disa modifikime dhe rinovime, duke përfshirë edhe shenjtëroren dhe altarin, u bënë të domosdoshme. Vëlla Ramon M.C. kontaktoi arkitektin, Inxh. Kolë Pema i cili e mori punën seriozisht, së pari çatinë, tavanin, derën kryesore dhe fasadën e kishës. Ajo që mbeti ishte shenjtërorja me modelin e vjetër të altarit, që gjithashtu duhej të bëhej. Faleminderit Zotit, gjithçka u bë pa shumë probleme serioze, edhe pse u desh pak kohë. Ajo që mbetet tani është dyshemeja, që do t'i duhet kohë para se të mund ta zëvendësojmë.

E jona nuk është famulli, por konsiderohet e tillë, derisa vendasit e Bushatit të kenë kishën e tyre më të bukur e më të madhe. Kjo është arsyeja pse kisha dhe altari nuk u shuguruan, por vetëm u bekuan. Në sajë të Shkëlqesisë së tij Angelo Massafra, i cili këmbënguli që ta rinovonim kishën dhe altarin për pak kohë. Më në fund u krye dhe tashmë u bekua solemnisht. Ndërkohë që kisha po bekohej nga Arqipeshkvi ynë, Zoti e bekoji pjesën e jashtme të kishës, në të vërtetë krejt Bushatin, krejt Shkodrën dhe mendoj se Zoti e bekoji bujarisht krejt Shqipërinë me një dush të ftohtë. Pavarësisht shiut dhe motit të ftohtë, kisha e Familjes së

Shenjtë u mbush tej kapacitetit të vet; njerëzit qëndronin edhe jashtë dere.

Imzot Angelo bëri një homeli mjaft të bukur. Njerëzit e dëgjonin me një vëmendje të pandërprerë. Falënderimet i shkojnë korit engjëllor, të organizuar nga vëlla Michael Joseph M.C. dhe motrave tona M.C. të Shkodrës, M. Marjeta dhe bashkësisë. Dy motra, këngëtares më të mira e korit të katedrales e bënë të kënduarit më engjëllor dhe solemn.

Ishin vetëm pesë vëllezër bashkëkremtues, Dom Dritani, famullitari i Rranxave dhe Dom Sharbeli, famullitar i Rragamit dhe drejtori i Caritas-i, Shkodër. Tre meshtarët e tjerë ishin vëlla Ramon M.C., vëlla Mathew M.C. dhe Atë Sebastiani M.C.

Atë Sebastiani M.C. bëri falënderimin e vet, teksti i të cilit jepet më poshtë. Ai foli në italisht dhe Marku, njëri prej seminaristëve, përktheu në gjuhën shqipe. E falënderojmë Markun, i cili bëri me të vërtetë një punë të shkëlqyer.

Pas bekimit të Kishës dhe të altarit, si shprehje e dashurisë dhe e mirënjohjes sonë për Zotin dhe të gjithë ata që na ndihmuan që nga fillimi i pranisë sonë në Bushat, vëlla Mathew M.C. dhe bashkësia kishin filluar ekspozimin/paraqitjen e të Shenjtërueshmit Sakrament në kapelën e madhe nga ora 9.00 deri në 12.00 dhe nga ora 15.00 deri në orën 18.00 nga e hëna deri të premten. Shpresojmë ta vazhdojmë këtë gjë përherë, për sa kohë që bashkësia jonë të jetë në Bushat.

Adhurimi i të Shenjtërueshmit Sakrament është një dhuratë dhe mister. Do të sjellë shumë hire dhe bekime për bashkësinë, për Bethel-in, për të varfrit tanë, në famullinë e Bushatit dhe të tjerë. Le të përpiqemi për më të mirën që ta shtojmë numrin e njerëzve që e duan dhe e adhurojnë Zotin në Eukaristi dhe ta duan dhe t'i shërbejnë Zotit në njerëzit tanë të varfër. Të gjithë janë të ftuar që të bashkohen me ne në këtë mision të dyfishtë. “Kurrë mos të ndalojmë së adhuruari!” (Shën Gjon Pali II). Le ta bëjmë shërbimin tonë me dashuri të madhe! Zoti ju bekoftë të gjithëve!

*Atë Sebastian Vazhakala M.C.
(Epror i Përgjithshëm)*

20 VJETORI I PROJEKTIT SHPRESA

Me rastin e njëzet vjetorit të Projektit “Shpresa” dhe me pjesëmarrjen e Ministrisë së Kulturës, në frymën e festivitetit, të rinjtë e kësaj shoqate performuan në një zhanër të ri teatral, atë të teatrit social, më 31 Mars, tek Motra Stigmatine në Giuhadol.

Nën drejtimin artistik, profesionist të z. Emiljano Palali, ata debutuan në shfaqjen me titull: “Black & White”, ku përmes kontrasteve sociale shprehej qartë autobiografia e secilit "aktor" në pritshmëritë e botëkuptimit shoqëror. Ngjarjet historitë, emocionet, perjetimet dhe ndjesitë e të rinjve tanë u shpalosën në tërë gamën e realitetit dhe sinqeritetit të tyre duke i dhënë publikut një atmosferë elektrizuese dhe një klimë artëndjeje, i cili reagoonte me ovacion gjatë pikave kulmore të spektaklit. Kjo shfaqje në hapësirën e saj artistike bëri që publiku të provonte ndjesi të skajshme: përlotjeje dhe hareje.

Një vëmendje të posacme treguan edhe mediat dhe televizionet lokale të cilat ishin të

pranishme në tërë përkushtimin e tyre. Madje para dhe pas spektaklit gëluan intervistat për mediat.

Vlen të përmendet ndihmesa e vyer e motër Dukata Radoja, që me gatishmërinë e saj të paepur i dha organizimit artistik mbështetje të pakursyer. Gjithashtu, përkrahja e rinisë vullnetare universitare si dhe ajo e shoqatës “Madonnina del Grappa” bënë që larmia e bashkëpunimit të arrijë në rezultatet e dëshiruara.

Prania e autoriteteve të larta klerikale, përherë e pamungueshme, Arqipeshkvi tonë, Imzot Angelo Massafra i dha vlera dhe kënaqësi angazhimit artistik, por dhe publikut i cili kishte në përbërjen e tij edhe aktorë profesionistë të Teatrit “Migjeni”.

Nuk mund të anashkalojmë dhe një fakt të rëndësishëm, pasi të gjitha këto arritje janë rezultat i cilësive dhe pasionit artistik të presidentit tonë z. Luigj Mila që me këmbëngulje përpiket të kanalizojë në veprimtari artistike dhuntitë e të rinjve të kësaj shoqate.

Tomi Delia



“BURGU I SPAÇIT - PSE MUZEUM?”



Sot me datë 23.05.2015, ne ambientet e Tirana International Hotel, u mbaj konferenca me temë “Burgu i Spaçit - Pse Muzeum?”

Kjo konferencë u organizua nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe në bashkëpunim me shoqatën “Muzeumi i Burgut të Spaçit” ne kuadër të përfundimit të projektit dyvjeçar “Ballafaqimi me të Kaluarën Komuniste në Shqipëri” të zbatuar nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe, me mbështetjen e organizatave gjermane Renovabis dhe Maximilian Kolbe.

Gjatë punimeve u diskutua mbi rëndësinë e zbatimit të vendimit të qeverisë shqiptare për kthimin e ish-burgut të Spaçit në Muzeum. Ndonëse ka kohë që vendimi është miratuar, zbatimi është zvarritur duke sjellë edhe përkeqësimin e mëtejshëm të kushteve fizike të burgut që është katandisur pothuajse krejtësisht në gërmadhë.

Rëndësia e ruajtjes së burgut të Spaçit, i cili është cilësuar nga historianët dhe opinionin publik si ikona e persekutimit Komunist në Shqipëri, është jetike jo vetëm për kujtesën historike kombëtare, por edhe për të shmangur gabime të tilla të së shkuarës, të cilët me siguri përsëriten me pasoja edhe më të mëdha në të ardhmen.

Mes të pranishmëve ishin ish të përndjekur politikë, mes të cilëve një numër i madh kanë kaluar një pjesë të jetës në burgun e Spaçit, autoritete të larta të shtetit, publicistë dhe analistë politikë. U vu re me kënaqësi një nivel i mirë pjesëmarrjeje e brezit që persekutimin komunist e njohin vetëm nga tekstet e përcipta të historisë dhe rrëfimet e prindërve. Fakti që ky brez ka interes për këtë pjesë të historisë, është tregues i vullnetit të tyre për t’u njohur me anët e errëta të së kaluarës sonë të cilat për shkak të interesave mesquine të individëve dhe grupeve të caktuara, janë lënë në heshtje.

Në fund të punimeve, të pranishmit hartuan një deklaratë të përbashkët e cila i bën thirrje autoritetve shtetërore dhe shoqërisë civile të tregojnë ndjeshmërinë e duhur në interes të dinjitetit të viktimave të persekutimit komunist dhe brezave që do të vijnë. Të vërtetat e kësaj pjese të historisë sonë janë të vështira për t’u thënë, por siç na e provon edhe shembulli i shoqërive të zhvilluara europiane, pa kapërcyer këtë prag nuk ka as pajtim, as përparim as integritim.

Konferenca u hap me fjalimin e Imzot Angelo Massafra, të cilin po e paraqesim në vazhdim:

I nderuar Nunci Apostolik, të nderuar Ambasadorë dhe Përfaqësues të Trupit Diplomatik të akredituar në Shqipëri, të nderuar Përfaqësues të

Organizatave të ish të përndjekurve politikë, të nderuar ish të përndjekur politikë.

Zonja dhe Zotërinj!

Më lejoni që në emër të organizatorëve, Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë dhe Shoqatës “Muzeumi i Burgut të Spaçit”, t’ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë.

Çështja e ballafaqimit të shoqërisë shqiptare me të kaluarën, konkretisht me aspektin e persekutimit komunist, prek të gjithë faktorët e saj, përfshirë strukturat shtetërore, shoqërinë civile dhe sidomos komunitetet fetare.

Them sidomos komunitetet fetare sepse ata ishin pa diskutim kategoria më e përndjekur nga regjimi diktatorial, me Klerin e Kishës katolike në krye, siç thonë shumë zëra. Po t’i referohemi vetëm persekutimit të Kishës Katolike në Shqipëri, kujtojmë 38 “martirë” të cilët presin kanonizimin zyrtar nga Selia e Shenjtë, që u arrestuan, dënuan dhe ekzekutuan gjatë regjimit komunist. Po ashtu, një numër shumë i lartë klerikësh dhe besimtarësh të dënuar me vite të gjata burgimi dhe pune të detyruar.

Duke qenë komunitetet fetare pararoja e vlerave më të larta morale dhe shpirtërore, e respektimit të të drejtave të njeriut, e fjalës së lirë dhe çdo koncepti tjetër mbi të cilin mbështeten shoqëritë e zhvilluara, mbi ta vërshoi edhe ndëshkimi më i egër.

Duke pasur parasysh këto fakte, nuk mund të mbajmë qëndrim indiferent kur flitet për temën e persekutimit komunist në Shqipëri.

Në ndryshim nga faktorët e tjerë të shoqërisë, këndvështrimi ynë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë kurrë politik. Ne duam të kontribuojmë me kapacitetet tona vetëm në interes të së drejtës universale dhe dinjitetit njerëzor, pa harruar për asnjë çast procesin e pajtimit. Pajtimi bazohet në kërkimin e faljes dhe në dhënien e faljes, si edhe në ndreqjen e drejtësisë mes palëve

Pikërisht në kuadër të këtij kontributi, organizojmë sot edhe këtë konferencë ku prej tematikës së gjerë të persekutimit komunist, kemi zgjedhur të përqendrohemi në një element konkret që në një farë mënyre është edhe simbol i asaj ligësie që karakterizoi regjimin e kaluar.

Do të flasim për Burgun e Spaçit dhe arsyet se pse ai duhet të kthehet në muzeum. Konferenca e sotme zhvillohet në kuadrin e përfundimit të projektit 2-vjeçar “Ballafaqimi me të kaluarën Komuniste në Shqipëri” të zbatuar nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe, pjesë e strukturave të Kishës Katolike në Shqipëri, dhe të mbështetur nga organizatat gjermane Renovabis dhe Maximilian Kolbe të cilat gjejmë rastin t’i falenderojmë. Tani do të degjojmë kumtesat e lektorëve, do të kemi diskutime dhe do të nxjerrim disa përfundime për të përcjellur zërin tonë në strukturat vendim-marrëse për rikthimin e burgut të Spaçit në muzeum.

Duke ju falenderuar të gjithëve për kontributin tuaj, për respektin, për kohën dhe për përkushtimin që shpreh prania juaj këtu, ju uroj punë të mbarë.

Imzot Angelo Massafra OFM, Arqipeshkëv Metropolit Shkoder-Pult, President i Komisionit Drejtësi dhe Paqe të Shqipërisë, Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë”.

Konferenca vazhdoi pasdreke me organizimin e grupeve të punës ku u bënë propozime konkrete për t’iu paraqitur institucioneve të ndryshme, vendase dhe të huaja.

Vladimir Banushi



“FAMILJA DHE RINIA PERBALLË SFIDAVE TË MODERNITETIT”



Me nismën e Imzot Angelo Massafra, që u pranua nga Myftinia dhe Kisha Ortodokse, më 13 maj 2015, në orën 19.00 u organizua në mjediset e kinema “Millennium” në Shkodër takimi ndërftetar me temë “Familja dhe Rinia përballë sfidave të modernitetit”. Ku morën pjesë autoritete të larta drejtuese si dhe figura të njohura të komuniteteve fetare të Shkodrës.

Duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën po ndryshon shoqëria në rrafshet e ekonomisë, politikës dhe qarkullimit të informacionit që po i jep asaj një profil global, edhe vlerat sociale në të cilat besojmë nuk mund të kalonin pa u ndikuar. Shkrimet e Shenjta dhe fryma e përgjithshme që predikohet nga komunitetet në Shkodër, pavarësisht ndryshimeve, kanë një të përbashkët të madhe: Familja është qeliza bazë dhe institucioni më i rëndësishëm i një shoqërie të shëndoshë. Ajo është bashkimi shpirtëror dhe fizik mes një burri dhe një gruaje dhe fëmijëve që ata sjellin në jetë me vullnetin e Hyjit.

Çdo interpretim tjetër për familjen – si fenomeni social modern për të quajtur të tillë edhe bashkimin në martesë të personave me të njëjtin seks – është shtrembërim i modelit hyjnor dhe do të ketë pasojë shkatërrimtare për shoqërinë.

Ky ishte edhe kumti që sollën për të pranishmit përfaqësuesit e komuniteteve fetare në fjalën e tyre përshëndetëse:

Komuniteti Katolik – Imzot Angelo Massafra, Komuniteti Ortodoks – Atë Nikolla Petani dhe Komuniteti Mysliman – Prof. Arben Halluni.

Mesazhet e Shkëlqesive të Tyre u argumentuan hollësisht nga tri ligjërata të mbajtura nga Atë Nikolla Petani, Dom Marian Gega, Imam Lavdrim Hamja.

Më poshtë po japim të plotë fjalën e rastit të mbajtur nga Imzot Angelo Massafra në takim:

“Mire mbrema te gjithëve!

Falenderoj Zotin përkëtë takim. Pëshendes dhe falënderoj Perfaqësuesit e Myftinisë së Shkodrës, Atë Nikolla Petani, famullitari i Kishes Ortodokse, Autoritete Civile, Mediat, Drejtorin e Kinemas, Bashkepunetoret, për kete mbremje kulturore nderfetare, me temen “familja dhe rinia përballë sfidave të modernitetit”

Në këtë vit kremtojmë 25 vjetorin e Meshës së parë në Varrezat e Rrmajt në Shkodër, kremtuar nga Dom Simon Jubani, past dritë, me dt. 4 nentor 1990 dhe e hapjes së Xhamisë së Plumbit, me 16 nentor 1990...për këtë kemi vendosur të bejmë disa nisma kulturore së bashku, siç është kjo sot.

Ky është një takim që pason takimin ekumenik dhe ndërftetar me Papa Françeskun në Tiranë, me 21 shtator

2014, ku Ai, midis të tjerave na është drejtuar me këto fjalë:

“Është e rëndësishme që jeni këtu së bashku: ...duke u përpjekur të lidhni me njëri-tjetrin marrëdhënie bashkëpunimi vëllazëror, për të mirën e mbarë shoqërisë. Faleminderit për atë që bëni.

I rëndësishëm është angazhimi në dobi të së mirës së përbashkët... Sa më shumë të jemi në shërbim të të tjerëve, aq më shumë jemi të lirë.

Le të shohim tek çdo burrë e grua, edhe tek ata që nuk i përkasin traditës sonë fetare, jo kundërshtarë, aq më pak armiq, por vëllazër e motra.

Të dashur miq, ju bëj thirrje ta mbani dhe ta thelloni traditën e marrëdhënieve të mira ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri dhe të ndjeheni të bashkuar në shërbimin ndaj atdheut tuaj të shtrenjtë”.

Na u drejtua edhe me këto porosi, që janë të lidhura me takimin e sotëm: “Sot erdha t’ju jap zemër, ta përforconi shpresën në ju dhe në mes Jush”...për këtë ju them të dini të thoni “jo” idhujtarisë së parave, “jo” lirisë se rreme individualiste, “jo” varësive të dhunës, “po” kulturës së takimit e të solidaritetit; “po” jetës së shkrirë për ideale të mëdha...që të ndertoni një Shqipëri më të mirë”

Në fund, kam dëshirë ta citoj shprehjen e Papa Gjon Pali II, në Nxitjen e Tij Apostolike mbi familjen: “Familje behu ajo që je: dmth: “bashkësi dashurie”.

Duke falënderuar kumtuesit dhe të gjithë juve këtu të pranishëm, uroj që familje tona dhe të rinj tanë të jetojnë më të bashkuar dhe të përvetësojnë vlerat më të çmueshme të modernitetit”.

Vladimir Banushi



“SHQIPTARËT DHE TRENTINËT NË PASQYRË” EKSPOZITA FOTOGRAFIKE NË TRENTO

Ekspozita fotografike “Shqiptarët dhe Trentinët në pasqyrë” kujton mbërritjen e 370 emigrantëve shqiptarë të zbarkuar 24 vjet më parë në Itali dhe të pritur në Trentino në kazermën Degol të Strinjos.

Ekspozita, që do të përurohet të dielën më 8 mars në orën 17.30 në sallën Caritro të rrugës Calepina, përfaqëson një nderim ndaj grave shqiptare që përballuan pasiguri dhe rreziqe për të krijuar një të ardhme më të mirë për bijtë e tyre, është vazhdim i një veprimtarie që Shoqata TEUTA është duke realizuar që nga viti 2008, për t'i qëndruar besnike misionit të vet “VETËM DUKE E NJOHUR THELLËSISHT KULTURËN TONË JEMI NË GJENDJE TË ÇMOJMË DHE TË RESPEKTOJMË ATË TË TJETRIT”.

Kjo nismë është pjesë e një itinerari reflektimi historik dhe nxitjeje të bashkëjetesës që përfshin shoqërinë trentine dhe të gjitha bashkësitë e emigrantëve. Ky projekt është realizuar me mbështetjen e Fondacionit Caritro dhe me bashkëpunimin e shumë enteve trentine; ekspozita do të hapet në Strinjo nga 21 marsi deri më 11 prill, në Pergjine nga 12 deri më 26 prill, në Rovereto nga 3 deri më 11 maj dhe përsëri në Trento nga 18 deri më 29 maj në hyrjen e Pallatit Trentini.

Nëpërmjet 30 paneleve me pamje fotokronike të shkrepura nga Roberto Bernardinatti, me komentin e Leonora Zefit dhe Marco Viola-s, ekspozita tregon mirëpritjen dhe jetën e emigrantëve brenda kazermës Degol të Strinjos, në Trentino.

Aty lexohen shpresat dhe druajtjet e shumë njerëzve që brenda pak

vitesh do të bëheshin fqinjët tanë të shtëpisë, muratori, punëtori, sipërmarrësi apo studenti universitar që ka kapërcyer paragjykimet dhe vështirësitë për të hyrë në një bashkësi të re dhe për të marrë pjesë me përgjegjësi e dinjitet në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike të kësaj toke.

Bashkësia shqiptare në Trentino që sot është e përbërë nga më shumë se 7.000 shtetas, është e dyta për nga numri, pas asaj rumune, dhe ka ditur të përfshihet plotësisht në shoqërinë trentine.



Ky projekt synon të përbëjë një copëz të mozaikut që përbën sot një shoqëri trentine të vetëdijshme për dinamikat që ndihmojnë për të krijuar shtetas të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës, një nxitje për reflektim mbi vlerën shoqërore të multikulturalitetit dhe të tolerancës. Në të vërtetë, imigrimi shqiptar, më shumë se të tjerët, paraqet një karakter që favorizon një rrënjë të fortë të personave, sepse fazën e parë të mbërritjes së burrave


normalisht e ndjek bashkimi familjar, për të ndërtuar së bashku dhe këtu të ardhmen e fëmijëve të tyre. Jo rastësisht bashkësitë më të para të shqiptarëve të ardhur në Itali për t'iu larguar përparimit të turqve në shekullin XV ende edhe sot janë të vendosura në Kalabri dhe Sicili, ku bashkësitë arbëreshe ruajnë të gjallë gjuhën, kulturën dhe traditat, megjithëse janë plotësisht të përfshira në kontekstin krahinor dhe kombëtar.

Leonora Zefi

BEKIMI I KISHËS SË RE KUSHTUAR SHËN GJERGJIT NË GORAJ-BUDISHË, KASTRAT

Fshati Goraj-Budishë, pjesë e famullisë së Shën Markut – Kastrat, ndodhet 35 km larg qytetit të Shkodrës. Vendi është shumë i bukur. Fshati ka 65 shtëpia, me një numër banorësh rreth 220 persona. Në qendër të fshatit kemi ndërtuar Kishën e re. Kisha e vjetër, që gjëndeje në mes të varreve Goraj, ku çdo të diel kremtohej Mesha, ishte e pabanueshme për kremtime liturgjike. Në vitin 2012, famullitari i asaj kohe, Atë Landi Jaku, futi themelet dhe filloi punimet për Kishën e re. Çatia dhe kolonat u dhuruan nga një shoqatë irlandeze.

Në vitin 2013 Kisha nuk ishte e përfunduar dhe kishte dalë shumë e vogël si ndërtesë. Në atë kohë menduam të ndryshojmë projektin e Kishës. Në projektin e ri, Kisha u



ndërtua krejtësisht e re. Dhe vendi ku ishte ndërtuar Kisha e mëparshme, u vendos që të përdoret si sallë për nevojat e besimtarëve. Krahas Kishës së re, u ndërtuan dy dhoma katekizmi bashkë me sakrestinë.

Projektin e Kishës së re e realizoi arkitekti Albert Lleshi. Realizimin dhe ndjekjen e punimeve i udhëhoqi Atë Ndue Toplana.

Për ndërtimin e Kishës kemi pasur fonde të ndryshme bamirësie. Një ndihmesë të madhe për gjetjen e fondeve na e ka dhënë Arqipeshkëvi i Shkodër-Pult Mons. Angelo Massafra. Po ashtu, na kanë ndihmuar shumë për ndërtimin e kësaj Kise, emigrantë prej Amerike, Anglie, etj., si dhe besimtarë që banojnë në Goraj-Budishë e në vende të tjera përrreth.

Me datën 2 maj 2015, në orën 10.00, u kremtua Mesha dhe u bekua Kisha e re kushtuar Shën Gjergjit. Për të marrë pjesë në Meshë kishin ardhur besimtarë prej

Vijon në fq. 10

IN MEMORIAM, DON CARLO ZACCARO

Me rastin e 5 vjetorit të ndarjes nga jeta të misionarit, Dom Carlo Zaccaro, i cili ka dhënë një kontribut të madh për qytetin e Shkodrës dhe Shqipërinë. Që nga marsi 1993 nisi bashkëpunimin me Universitetin e Shkodrës dhe Universitetin e Firences, si dhe me ente e personalitete italiane. Në nëntor 1999 krijon Filialin e Operas në Shkodër, që ka në administrim 3 shtëpi familje, e pastaj krijon shoqaten, “I-CARE”.

Në dhjetor 2000, inauguron Qendrën Shëndetësore për shërbimet ndaj të sëmurëve dhe në veçanti për fëmijët kardiotipikë, e cila aktualisht ndodhet në Gjuhador-Shkoder. Për merita të veçanta, në 1995 i akordohet nga Presidenti i Shqipërisë medalja, Urdhri i Artë “Naim Frashëri” në 1996 Këshilli Bashkiak Shkodër e nderon me titullin "Qytetar Nderi" i Shkodrës.

Gjithashtu në dhjetor 2006, Presidenti i Italisë i jep medaljen, "Kalarësi i Urdhrit të Meritës së Republikës Italiane", dhe në 2010 Bashkia e Shkodrës emërton një nga rrugët e qytetit me emrin e Tij.

E si te mos kushtohet një ditë “in Memorium” të meshtarit, mësuesit, edukatorit siç ishte Dom Carlo Zaccaro. Dita fillon me bekimin e Zotit, me kremtimin e meshës së Shenjte në Kishen Franceskane, nga Imzot Angelo Massafra së bashku me meshtarët e tjerë, dhe përgjegjësit të Madonnina del Grappa, Dom Vincenzo Russo i cili erdhi nga Italia për këtë rast. Nuk mungonin Autoritetet vendore dhe institucionale, të rinjtë vullnetarë dhe personat me aftësi ndryshe të cilët Dom Carlo i kishte përzemer. Ishte mjaft prekesë, Ofrimi i dhuratave nga personat me aftësi ndryshe të cilët shoqëroheshin nga vullnetarët, sepse mes kufizimit të tyre dominonte alegria për të dhuruar dhe shërbyer. Në këtë rast rrezatonte kori polifonik “Prenk Jakova” me dirigjent Gjon Shllaku.

Menjëherë vijojme me dreken e organizuar nga Fabrizio dhe Moter Dukata, tek Qendra Madonnina Del Grappa, prania e rreth 150 personave ndër të cilët miq të Don Carlos, njerzit me aftësi ndryshe bashkë me edukatore, bashkëpunetore e vullnetare. Të shikosh gezimin në sytë e tyre teksa na falenderonin për çdo shërbim që ju ofrohej, madje dhe kenget e Buqes thenin çdo lloj lloj heshtjeje. Rinia Vullnetare Universitare qendroi e konsoliduar gjatë këtij aktiviteti për të cilën duheshin forca për të përfunduar me sukses.



Vazhdon kështu në klime feste mbasditja ku organizohet konferenca “In Memoria”m, e cila u hap me përshendetjen e Dom Vincenso Russo, duke vijuar me dokumentarin e përgatitur nga Prof. Dr. Gjovalin Kolombi. Kthehemi në kohë, pikërisht në vitet nostalgjike dhe veprat e Don Carlos që tashmë janë të përmbledhura në 35 min, jo shumë për të përshkruar misionin e Don Albania (sikurse shkruanin gazetatat Italiane), por rrjedhja kronologjike e historisë sjell vepren e gjallë të tij në vite. Pastaj vijoj me ligjeratën e Willy Kamsit, “Don Carlo Zaccaro, përçues drite dhe mirësie”, të cilën për arsye shëndetësore e percjelli, Prof. Gjovalin Cuni. Don Carlo jepte gjithmonë keshilla dhe të drejtonte drejt shpresës, besimit tek Provania Hyjnore dhe shërbimit, ai drejtohej gjithmonë me kete shprehje ;”Bëj gjithcka e beje mirë, dhuro e dhuro me gëzim”- vazhdoj kështu Z. Fabrizio Nocchi përgjegjës i Madonnina del Grappa, në Shkodër e pastaj Andrea Jakova, Jurist.

Nuk mund të mos cekej ndihma që dha Don Carlo në përparimin e Univesitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, nenvizon Prof. Dr. Gjovalin Kolombi, kur ishte rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, të asaj kohe. Gjithashtu me të njejtin ton pohon në ligjeratën e Tij, për Bashkëpunimin e Don Carlos me drejtuesit e pushtetit vendor Prof.

Dr Filip Guraziu ish kryetar i pare i Bashkisë Shkoder, pas rrezimit të Komunizmit.

Por jo me pak vemendje u dëgjua Dr. Arketa Pllumi e cila foli për mënyrën se si funksionoj Ambulatori në shërbim të sëmurëve dhe të fëmijëve kardiotipikë, pershendetjet dhe falënderimet e fëmijëve që janë operuar dhe tashmë gëzojnë jeten në mënyrë të shëndetshme.

Jo vetem, vepra e Don Carlos vjon më tej, ishte e nevojshme që kursi shërbimi Fizioterapik të bëhej shkollë dhe shërbim..., sot fizioterapistet e diplomuar punojnë në ente private dhe shtetërore duke treguar aftësi profesionale dhe njerezore, ligjeron Mt. Dukata Radoja. konferenca vijoj me fjalën përshendetëse dhe bekimin e Imzot Angelo Massafra, duke përmbyllur një ditë përkujtimore të 5 vjetorit të ndarjes nga jeta e Dom Carlo Zaccaro si një familje se bashku, për koktail tek Resorant Vivaldi.

Rovena Precetaj (Prekulaj)

BEKIMI I KISHËS SË RE KUSHTUAR SHËN GJERGJIT NË GORAJ-BUDISHË, KASTRAT

Vijim i fq. 9

Bratoshit, Bajze e natyrisht prej Goraj-Budishë. Gëzimi shihej dhe prekej në fytyrat e të gjithëve. Ishte gëzimi i parë që përjetonte fshati, qysh mbas shembjes së komunizmit. Kisha ishte mbushur plot me besimtarë. Meshën dhe bekimin i udhëhoqi Imzot Angelo Massafra. Bashkëkremtuan Atë Aurel Gjerkaj, Epror i fretërve, dom Dedë Demaj si dhe fretër e meshtarë të tjerë që kishin ardhur nga Shkodra.

Gjatë predikimit, Imzot Angelo ftoi besimtarët që ta vlerësojnë Kishën e re e sidomos të ndërtohet bashkësia si gur i gjallë i Kishës. Çdo ditë duhet të rritemi në fe, ta njohim dhe ta duam sa më shumë Krishtin, Shëlbuesin tonë. Dhe këtë marrëdhënie me Zotin tonë, ne duhet ta shfaqim në jetën tonë të përditshme, përfundoi Imzot Angelo.

Në fund të Meshës, përshëndeti Atë Aurel Gjerkaj, i theksoi se bashkë me besimtarët,



Provinca Françeskane e Zojës Nunciatë, ka dhënë kontribut të madh për ndërtimin e Kishës së re. Fretërit nuk i fitojnë lekët në sajë të një mekanizmi fitimprurës, por ato i kanë prej bamirësve dhe janë shenjë e provanisë së Zotit. Prandaj, Kisha duhet të konsiderohet e të gjithëve, dhe të gjithë të vijnë kontributin e tyre për mirëmbajtjen e saj.

Në fund famullitari Atë Vitor Demaj, falenderoi Imzot Angelo Massafren për afërsinë e tij me besimtarët, Atë Aurel Gjerkajn për ndihmesën e madhe të Provincës françeskane në ndërtimin e këtij tempulli, P. Ndue Toplanan për realizimin e projektit, si dhe krejt besimtarët për kontributin e tyre, ku pa të cilët kjo vepër e Zotit nuk do të ishte realizuar. Mbas Meshës u organiza një koktejl për të gjithë të pranishmit.

Fra Vitor Demaj

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

BEKIMI I QENDRËS BARITORE “SHËN GJON PALI II” - GRAMSH

Bashkësia e famullisë së Shën Nikollit Gramsh, pasditen e 12 majit 2015, gëzoi për Bekimin e Qendrës Baritore kushtuar “Shën Gjon Pali II” dhe për 8 vjetorin e kushtimit të Kishës. Në emër të të gjithë bashkësisë famullitare, famullitari Dom Artur Kola i uroi mirëseardhje Imzot Lucjan Avgustinit, ku kjo famulli tha ai, ndjehet e nderuar me prezencën e tij që na ka dëshmuar gjithmonë dashuri dhe kujdes ndaj bashkësive tona. Në meshën e kryesuar nga ipeshkvi, bashkëmeshuan edhe meshtarë të tjerë të dioqezës sonë në prani të shumë besimtarëve të famullisë, të cilët ishin tejet të gëzuar për realizimin e një qendreje të tillë, e cila do të shërbejë për veprimtarinë baritore, për edukimin dhe formimin e brezave të kësaj famullie.

“Sot është dita që na e dhuroi Zoti, të gëzojmë e të galdojmë”! Me këto fjalë të psalmistit, Imzot Lucjani dëshiroi të shprehte gëzimin dhe falenderimin ndaj Zotit si dhe bamirësve për këtë dhuratë që i bëhet kësaj bashkësie. Kjo famulli, vazhdoi më tej ipeshkvi, gëzon në këtë ditë, ditë që na nxitë të kujtojmë në lutjet tona të gjitha ata që kanë punuar ndër vite për ndërtimin shpirtëror dhe ndërtimin si ndërtesë të kishës; veçanërisht lutemi dhe kujtojmë famullitarët që kanë shërbyer e tani janë në amshim,

Dom Injac Dema dhe Dom Genc Tuku. Duke e vlerësuar këtë ndërtesë që është pikë frymëzimi shpirtëror për të gjithë, Imzot Lucjani ftoi banorët e kësaj famullie që të ndërtojnë në vendin e tyre një shoqëri të mbështetur në vlerat e jetës së fesë. Nëse feja e jonë është e çmueshme për ne, atëherë asgjë nuk mund të na pengojë në udhën tonë me Hyjin, sepse Ai është siguria e fitores sonë mbi të keqen.

Pas meshës u bë bekimi i qendrës, ku të gjithë iu lutën Zotit që si bariu i shpirttrave tanë, të ndihmojë të gjithë ata që do të frekuentojnë këtë qendër që të rriten në pjekurinë njerëzore e të krishterë, që të mund të bëhen drita e botës dhe kripa e tokës.

Gëzimin e kësaj feste e shtoi edhe programi artistik i të rinjve të famullisë ku përcollën momente argëtuese dhe humori. Më pas u shtrua edhe një koktejl i vogël për të gjithë.

Qendra “Shën Gjon Pali II” u ndërtua falë bamirësve, posaçërisht organizatës së njohur të kishës së Konferencës Ipeshkvore Gjermane “Renovabis”, dhe Konferencës Ipeshkvore të Amerikës, të cilët e mundësuan këtë vepër me dëshirë që të jetë vend burimi dhe edukimi i një dashurie për Zotin dhe për njëri-tjetrin, të jetë vend i edukimit dhe formimit shpirtëror për të gjithë brezat.



KUSHTIMI I PËRJETSHËM I MOTËR FLORA GJOKA



Në këtë vit të Jetës së Kushtuar dhe në këtë kohë të gëzimit të Pashkëve, Zoti i dhuroi dioqezës së Sapës një tjetër gëzim. Bashkësia e motrave Dorote të Shën Paola Frassineti dhe familja Gjoka në të dielen e Bariut të Mirë, 26.04.2015, me gëzim të madh festuan kremtimin e kushteve të përjetshme të Motër Flora Gjoka. Të bashkuar rreth tryezës eukaristike në Katedralen Nënë Tereza në Vau-Dejës, besimtarë të famullisë së Shën Nikollit, familjarë, miq e të afërm të saj, falenderuan Zotin për dhuratën e kushtimit të Motër Flores, për thirrjen dhe vendosmërinë e saj për të marrë pjesë në misionin e Krishtit duke jetuar dhe duke e shpallur dashurinë e Ringjalljes së Tij.

E pranishme ishte edhe eprorja e përgjithshme e Motrave Dorote të Shën Paola Frassinetit,

Jaci Dutra Pessoa, dhe Provincialja Motër Silvia Ostren të shoqëruara nga këshilltaret e tyre nga Roma. Kremtimi eukaristik u udhëhoq nga Ipeshkëvi i vendit Imzot Lucjan Avgustini në bashkëkremtim me meshtarë të tjerë.

Ndërsa në fjalën e rastit, ipeshkvi u ndal në rëndësinë e thirrjes dhe jetës së kushtuar Zotit për lavdinë e tij dhe për shërbimin ndaj njerëzve. Çdo thirrje lind prej takimit të dy lirive, asaj hyjnore dhe asaj njerëzore. Çdo thirrje nxitet prej Zotit si një dhuratë për bashkësinë e krishterë. Ndaj edhe motër Flora tha ipeshkvi, duke e pasur shembull Po-në e

Marisë, shpreh dëshirën, jep përgjigjen dhe zgjedhjen për një përcaktim jetësor për të bashkëpunuar me Zotin sipas Kongregatës së themeluar nga Shenjtja Paola Frassineti.

Imzot Lucjani preferoi të citonte fjalët e Shën Gjon Pali II në “Nxitjen apostolike” i cili thotë: “Jetojeni në plotësi kushtimin tuaj Hyjit, për të mos lënë që kësaj bote t’i mungojë një rreze e bukurisë hyjnore e cila ndriçon ecjen e ekzistencës njerëzore”.

Pas predikimit, në prani të eprores, ipeshkëvit dhe mbarë bashkësisë, u mbajt riti i kushtimit të përjetshëm të motër Flores , që me liri dhe vetëdije të plotë shpalli zgjedhjen e saj dhe dëshirën për ta ndjekur Jezusin duke bërë Kushtet e Pastërtisë, Varfërisë dhe Dëgjësës si përgjigje feje të dashurisë falas të Hyjit.

Motër Flora Gjoka lindi në Pukë me 20/02/1974 në një familje ku dashuria e feja ishin dy binarë që kanë bërë të mundur të rritet dëshira për t’ju dhuruar Zotit përgjithmonë. Është pagëzuar nga don Gjergj Vata në vitin 1993 dhe krezmuar në vitin 2001 nga Mons Dodë Gjergji. Mësimet e para dhe shkollën e mesme i kreu në vendlindje. Thirrja e saj për të ndjekur Jezusin e ka zanafillen në famullinë e Shën Nikollit të fshatit të lindjes Kçirë. Në vitin 2000 pasi familja u zhvendos me banim në qytezën e Vau Dejesit, motër Flora pati mundësi të njohë Motrat Dorote, e në veçanti moter Mariza Gobo, me të cilën hapi zemren dhe shprehi dëshirën e saj që prej shumë vitesh kishte pritur që të realizohej. Ajo thotë: kur kam takuar motrat Dorote për herë të parë, kam parë thjeshtësinë, kam ndjerë dashurinë dhe kam provuar kënaqësinë e të jetuarit së bashku për një qëllim “Ungjillin”. U pranua nga motrat në gusht të vitit 2001 dhe pas tre vitesh filloi noviciatin në Romë. Me 18/10 2008 bëri kushtet e para në kapelen e shenjtes Paola. Pas kushteve filloi misionin e saj në Shkodër duke shërbyer në famullinë e “Zojës Rruzare” Arra e Madhe, dhe duke ushtruar detyrën e kujdestares së konviktit hapur posaçërisht nga motrat Dorote për vajzat që vinin nga zonat malore për të studiuar në Shkodër. Aktualisht po përfundon studimet në Seminarin Ndërdioqezan “Zoja e Këshillit të mirë“ në Shkodër.

Violeta Marashi

TOKA NXJERR NË DRITË RELIKE TË ÇMUESHME



Gjetje e jashtëzakonshme!

Më 12 mars, përkujtimi i 75 vjetorit të vdekjes së shën Luigj Oriones, themeluesit të Veprës së Vogël të Provanisë Hyjnore (Orioninët) na ndodhi një fakt i jashtëzakonshëm. Pasdite herët erdhën në shtëpinë tonë në Bardhaj dy të rinj të fshatit me një pako të


cilën ma dorëzuan mua. Kur e hapa, për befasinë time të madhe, pashë se kishte disa objekte fetare mjaft të hershme dhe disa edhe pak të prishura: kelke të vogla, pikside, figura shenjtërisht, mbajtëse qirinsh si dhe një figurë të bukur të Zojës së Këshillit të mirë në allçi me një kornizë druri. Gjetja kishte ndodhur në një shtëpi afër kishës së Shën Kollit. Shtëpia mjaft e vjetër ishte blerë prej vëllezërve Stafaj, Martini, Antoni, Kristjani, Nikolini, Gjini e Paulini. Shtëpia e braktisur prej kohësh kishte nevojë urgjente për restaurim.

Me një grup muratorësh kanë filluar të prishnin dyshtemenë e vjetër dhe nga poshtë pllakave të sallës ka dalë një arkë druri që ishte thërrmuar sapo e kishim prekur, por brenda saj, të mbështjella me plastmas, kanë gjetur një seri objektesh fetare. Menjëherë i kanë marrë dhe ia kanë sjellë meshtarit të fshatit të tyre. Don Rolando që i ka pritur, duke kuptuar vlerën historike dhe fetare të

objekteve të gjetura, i ka marrë të gjitha dhe ia ka çuar arqipeshkvit, i cili është duke përgatitur muzeeun dioqezan dhe aty do të ruhen. Ditën e nesërme, don Rolando ka shkruar personalisht për t'i takuar të rinjtë që punonin në vendin e gjetjes.

Shtëpia u përkiste Gjush dhe Çile Ljarjes. Çilja është mbesa e poetit Pashko Vasa. Banonin shumë afër kishës së Shën Kollit dhe ishin një familje fisnike dhe shumë e devotshme. Kanë pasur 3 fëmijë, dy djem dhe një vajzë. I pari, Nard Ljarja, kur vdiç Stalini u dënua me 18 vjet burg për agjitacion e propagandë antikomuniste (bëri vetëm 13 vjet). I vëllai Ndoci ka bërë 8 vjet burg. Asnjëri prej të dyve nuk është martuar. Motra e tyre quhej Oli. E fshehën këtë thesar të vogël devocioni dhe feje para arrestimit dhe ai doli përsëri në dritë rastësisht më 12 mars 2015. Lajmet mbi familjen Ljarja janë mbledhur nga Ferdinand Baba bashkëpunëtor i orioninëve.

Don Rolando Reda



HAPËSIRË MEDIATIKE

Registrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matjia

Faqosja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë